

V E N D I M
Nr.327, datë 26.6.1995

PËR NJË SHITESË NË PIKAT 8 DHE 9 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.243, DATË 15.5.1995 “PËR SHPENZIMET PËR PRITJE, PËRCJELLJE DHE
TRAJTIMIN QË U BËHET DELEGACIONVE TË HUAJA”

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 15.5.1995, të bëhet një shtesë me këtë përmbajtje:

“Për grupin e tretë, pritjet e të cilave do të bëhen në Ministrinë e Punëve të Jashtme, kuota për çdo pjesëtar të jetë 60 lekë”.

2. Në pikën 9, në paragrafin e dytë të kësaj pike, të shtohet:

“Po ashtu edhe titullarët e përfaqësive tona diplomatike jashtë shtetit, kur e gjykojnë të arsyeshme për raste tepër të veçanta, me miratim të ministrit të Punëve të Jashtme, mund të japin dhurata deri në 100 dollarë brenda fondit për pritje e përcjellje të çdo përfaqësie për periudhën përkatëse”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi